



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1030/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Rr. “Perëndori Justinian” nr. 124 Prishtinë, kundër debitorit “RTK2” me NRB 600294657, me seli në Rrugën “Xhemail Prishtina” nr. 12 Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 804/21 të datës 03.08.2021, të Përmbaremit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “RTK2” me seli në Prishtinë, ANULOHET urdhri përmbaremore P.nr. 804/21 të datës 03.08.2021, të Përmbaremit Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përmbaremit Privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr. 804/21 të datës 03.08.2021, duke lejuar përmbaremit në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. 0002907 të datës 21.01.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “ RTK2” , që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, në afat prej 7 ditësh, të ia paguaj shumën prej 500.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe ato të përmbaremit privat me ndalimin e mjeteve monetare, regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri përmbaremore i lëshuar nga përmbaremit privat është në kundërshtim me Ligjin e Procedurës Përmbaremore, dhe sipas nenit 29 parë. 3, fatura e paraqitur nga kreditori nuk është nënshkruar nga debitori dhe se nuk ka prova se si është dorëzuar debitorit, nuk është cekur afati i përmbushjes së detyrimit, ashtu që urdhri i përmbaremit privat është lëshuar vetëm në bazë të kësaj fature dhe me këtë raste është bërë lejimi i përmbaremit në kundërshtim me dispozitat e

LPP-së, pos pretendimeve tjera i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes të autorizuarit të tij, ndër të tjera ka pretenduar se sa i përket pretendimit se fatura nuk është nënshkruar nga ana e debitorit si dhe nuk ka prova që është dorëzuar tek debitori, kreditori thekson se ky konstatim nuk është i saktë, dhe se fatura është dorëzuar debitorit ashtu sic dorëzohet çdo të licencuari në çdo fillim vite, për pagesën e tarifës për licencë së bashku me shkresën nga Departamenti për Licencim, e të cilën debitori e ka nënshkruar dhe eka pranuar e të cilën e paraqesim si provë. Me pranimin e shkresës së licencimit konsiderohet se është pranuar edhe fatura pasi që është pjesë integrale e shkresave, pos pretendimeve tjera gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përmbarimor të ngelet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr. 000879 e datës 16.01.2015 nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë e përshtatshme për përmbarim për faktin se e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit si institucion, andaj nuk mund të vërtetohet se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka bashkëngjitur asnjë provë nga e cila dëshmohet se fatura është dorëzuar në ndonjë formë tjetër

tek debitori, ashtu që ky i fundit e ka pranuar faturën dhe është njoftuar lidhur me detyrimin që rrjedh nga fatura e tillë.

Gjykata vlerësoj pretendimin e kreditorit paraqitur në përgjigje në prapësim se debitori e ka pranuar me post faturën me dokumentet e licencimit, ndërsa nga fletë kthesa postare e cila gjendet në shkresat e lëndës, nga e njëjta nuk mund të konstatohet si dorëzim i rregullt, pasi që nga fletë kthesa konstatohet te lloji i dërgesës nuk ka shënim se cila dokumente janë dorëzuar por figuron vetëm “024/”, andaj Gjykata në bazë të kësaj flete kthese nuk mund të konstatojë se ky dorëzim është i rregullt, në mungesë të shënimeve tek lloji i dërgesës, pra nuk mund të argumentohet se janë dorëzuar faturat apo ndonjë dokument tjetër tek debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë përderisa fatura rezulton të jetë lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit, andaj edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.1030/22, datë 20.06.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.